



A K T I I T H E M E L I M I T
I SHOQËRISË TREGTARE "I N A"-96" SH.P.K.

bazë të ligjit nr 7512, datë 08.10.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarisë private të pa varur dhe privatisimit" si dhe ligjit nr 7638, datë 19.11.92 "Për shoqëritë tregtare", me vullnetin e lirë, zonja Brunilda Gjineci, me zotësi të plotë juridike, shpall si vijon:

Neni 1

Formohet Shoqëria Tregtare Private "INA-96" SH.P.K. me themeluese zonjën Brunilda Gjineci.

Neni 2

Kjo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të themeluesve në kapitalin themeltar.

Neni 3

Shoqëria e ka selinë e saj në lagjen nr 1 Çorovodë. Ajo mund të hap seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjensi operative në të gjithë territorin e R. SH. Dhe me miratimin e organeve kompetente, edhe jashtë vendit.

Neni 4

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj në një afat pa caktuar, mbi dhjetë vjet. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo shkak. Për këtë caktohet një ose du likuidatorë.

Neni 5

Objekt i veprimtarisë do të jetë:

-Ndërtime e punime, dheu, armature, beton arme, shëmbjesh, ndërtime civile, industriale, turistike, rrugore.

-Punime restaurimi.

-Ujësjiellësa, kanalizime, impjante vaditës, etj.

Neni 6

Kapitali fillestar i shoqërisë, është 100 mijë lekë vendosur nga vetë themeluesja e saj. Kapitali mund të ndryshojë sipas veprimtarisë së punimeve. Kuata është e emërtueshme dhe e pa ndashme. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

Neni 7

Shoqëria do të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit të saj ekonomik, të ruajë sekretin, të mos dëmtojë interesat e Shoqërisë dhe personave të tjerë.

Neni 8

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje "INA-96 SH.P.K. Skrapar"

Neni 9.

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- 
- Administratori.
 - Këshilli administrativ.
 - Sektori i financës.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e punës së organeve drejtues do të rregullohet me statut.

Neni 10

Administrator dhe drejtues teknik i shoqërisë "INA-96 SH.P.K.", është zonja Brunilda Gjineci, lindur në 3.11.1968 në Korçë dhe banuese në Gërovodë.

Neni 11

Konfliktet që mund të lindin në shoqëri, gjatë veprimtarisë së saj do të zgjidhen me gjyq.

Neni 12

Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij akt themelimi e të statutit, i cili formulohet e nënshkruhet nga administratori në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 13

Statuti i Shoqërisë, është pjesë përbërëse e këtij akt themelimi.

Neni 14

Ky akt themelimi do të hyjë në fuqë pas miratimit nga organet kompetente.

Neni 15

Ky akt themelimi përpilohet në disa kopje për t'u shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin e Shoqërisë.

BRUNILDA GJINECI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

Nr. 154 rep.

Nr. 30 kel.

V E R T E T I M

Vertetohet se sot me datën 9 janar 1996 (nëntëdhjetë e gjashtë) përpara meje Neteres Publike u paraqit personalisht Z. Brunilda Gjineci e cila ka bërë aktin e themelimit për krijimin e një Shoqërie private. Konstatova se është madhërs me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u sigurova mëpërmjet dokumentit personal. Nënshkroi përpara meje Neteres. Unë Neterja e vertetohet ligjërisht



NOTERE

NOTERE
VIOLETA ISAR
TIRANE



Violeta Isari
Notere



S T A T U T
I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE
"INA-96 SH.P.K.

Në bazë të ligjit nr 7512, datë 08.10.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarisë private, të pa varur dhe privatizimit", si dhe ligjit nr 7638, datë 19.11.92 "Për shqëritë tregtare", me vullnetin e lirë, zonja Brunilda Gjineci, me zotësi të plotë juridike, shpall si vijon:

~~Neni 1~~ **FORMIMI I SHOQËRISË TREGTARE PRIVATE**

Neni 1

Formohet Shoqëria tregtare private "INA-96" SH.P.K. me themeluese zonjën Brunilda Gjineci.

F O R M A

Neni 2

Shoqëria tregtare private, është me përgjegjësi të kufizuar dhe përbëllon humbje vetëm në kufirin e vlerës së kontributit të kapitalit themelues,

SELIA E SHOQËRISË

Neni 3

Shoqëria e ka selinë e saj në lagjen nr 1 Çorovodë. Ajo mund të hapë seli të dyta, degë e filjale, përfaqësi dhe agjensi operative, në të gjithë territorin e R.SH. Dhe me miratimin e organeve kompetente, edhe jashtë vendit.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 4

Shoqëria tregtare private, do të ketë kohëzgjatjen dhe veprimtarinë e saj, në një afat të pa caktuar, mbi dhjetë vje. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë e për çdo shkak.

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 5

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

-Ndërtime e punime dheu, armature, betonarme, shëmbjesh, ndërtime civile industriale, turistike, ndërtime rrugësh, etj.

-Punime restaurimi.

-Ujësjiellësa, kanalizime, impjante vaditës, etj.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali fillestar i Shoqërisë, është 100 mijë lekë. Kapitali mund të ndryshojë sipas veprimtarisë së punimeve. Kuata është e emërtueshme dhe e pa ndashme. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkruar shëm. Çdo kuata i takon e drejta e një vote.

Neni 7

Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga kapitali fillestar, mjetet e xhir dhe të tjera të nevojshme, të luftshme apo të paluftshme për ushtrimin

aktivitetit të Shoqërisë.

Neni 8

Largimi i të punësuarëve në Shoqëri, nuk i përjashton ata për detyrimet që kanë ndaj saj para largimit.

Neni 9

Fitimet që do të realizohen gjatë veprimtarisë e që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve, periudike e vjetore, ndahen në bazë të kontributit, por kudoherë pasi të jenë shlyerë detyrimet.

Neni 10

Shoqëria Tregtare Private "INA-96 SH.P.K", është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë e mund të shfrytëzojë të drjta materiale ose jo materiale, duke përfshirë edhe të shitjes së pasurisë së vetë tek të tretët. Në R.SH. kjo Shoqëri gëzon të drejta si çdo person tjetër juridik shqiptar ose i huaj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 11

Shoqëria tregtare Private, vepron në rregjistrin e pronës dhe merr përsipër të drejta dhe detyrime vetëm brenda kapitalit të saj.

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË.

Neni 12

Organet drejtuese të Shoqërisë do të jenë:

- Administratori.
- Këshilli administrativ.
- Sektori i financës.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e punës e organeve drejtuese të saj, do të rregullohen si më poshtë:

KËSHILLI ADMINISTRATIV

Në Këshillin administrativ do të bëjnë pjesë administratori, drejtuesi teknik dhe një nga përfaqësuesit e sektorit të financës. Këshilli drejtohet nga administratori.

Neni 13

Administratori i Shoqërisë dhe drejtues teknik zonja Brunilda Gjoni.

Neni 14

Shoqëria fiton zotësinë e saj për të vepruar, me rregjistrimin e saj në Gjykatën e rrethit Tiranë dhe ushtron veprimtarinë ekonomike me rregjistrimin e saj në organet përkatëse tatimore.

Neni 15

Shoqëria ka vulën e saj me mbishkrimin "INA-96 SH.P.K.Skrapar"

Neni 16

Administratori, sipas nevojave që paraqiten, për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike financiare, punëson persona të ndryshëm specialistë në shoqëri.

Neni 17

Administratori dhe personat e ngarkuar prej tij, janë të veshur me gjithë fuqinë për detyrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, pa asnjë kufizim. Ata kanë të drejtë, midis të tjerave, të blejnë e këmbojnë pasuri, që lidhen me shoqëri të tjera, të ngritura jashtë e brenda vendit, duke siguruar pjesmarrjen për qëllimet e veprimtarisë të parashikuar nga neni 5 i këtij statuti. Ata kryejnë çdo llojë veprimi pronë të gjitha zyrave, shtetërore dhe private, që kanë të bëjnë me garancitë dhe veprime hipotekore, pagesa dhe arkëtime si dhe veprime të tjera që i shërbejnë aktivitetit. Në këto raste personi i ngarkuar nga administratori, është i detyruar të raportojë dhe ti japë llogari atij.

Neni 18

Administratori emërton administratorë të tjerë, të cilëve në aktin themelimit u cakton detyrat dhe pagën, po kështu vepron dhe me personat të tjerë të punësuar. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat e punësimit në R.SH. dhe sig shoqërore, ndërsa të gjithë të punësuarit, janë të detyruar të pranojnë statutin e Shoqërisë.

MARRDHËNJET E PUNËS

Neni 19

Marrdhënjet e punës në këtë Shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për qashtjet që nuk rregullohen në kontratë, zbatohen rregullat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Mosmarrveshjet e punonjësve me Shoqërinë do të zgjidhen në gjykatë. Punonjësit e emëruar, nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga Shoqëria gjatë veprimtarisë së saj. Për punën e kryer punonjësit marrin pagë siç është parashikuar në kontratë.

Neni 20

BILANCI DHE TË ARDHURAT

Veprimet ekonomike financiare të Shoqërisë fillojnë me rregjistrimin në organin tatimor dhe do të mbyllen në 31 dhjetor të çdo viti, veç urdhërave të veçanta. Në fund të çdo periudhë ushtrimore, bilanci kontabël mbyllet sipas ligjeve në fuqi. Bilanci kontabël miratohet nga Këshilli dhe nënshkruhet nga administratori. Me miratimin e tij Këshilli vendos për krijimin e fondeve të ndryshme të nevojshme, si dhe ato të akumulimit rezervë e tj.

Neni 21

Të ardhurat neto, pas veçimit të fondeve të përmendura më sipër, dhe shlyerjes së detyrimit fiskal, i mbeten në përdorim të Shoqërisë. Fitimi realizuar ndahet sipas kontributit në kapital.

SHPËRNDARJA E SHOQËRISË

Shpërndarja e Shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çdo nga shkaqet: Humbje e kapitalit, pamundësi veprimi ose me vendim të administratorit. Në këtë rast vendoset për mënyrën e likuidimit, duke caktuar një

ose dy likujdatorë, duke ju caktuar detyra. Administratorët dhe likujdatorët janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë deri sa t'ua dorëzojnë personave përkatës fizik e juridik, duke likujduar në radhë të parë personat e tretë të Shoqërisë. Nëse fondet, që disponojnë janë të pamjaftueshme për shlyerjen e detyrimeve të Shoqërisë, likujdatorët mund të kërkojnë nga administratori kuatën e nevojshme të parave.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Artikulli 23

Për sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësisht që do të bëjë Këshilli Administrativ si dhe ligjeve të veçanta të legjislacionit shqiptar. Detyrimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë e procedurë, me të cilën nxirret vetë statuti.

Artikulli 24

Ky statut përpilohet në disa kopje për tu shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje mbahet në dokumentacionin bazë të kësaj shoqërie. Statuti hartohet dhe miratohet nga administratori.

BRUNILDA GJINECI

REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA E NOTERISE TIRANË


Nr. 158 rep.

Nr. 31 kel.

V E R T E T I M

Vertetohet se sot me datën 9 janar 1996 (nëntëdhjetë e gjashtë përpara meje Neteres Publike u paraqit personalisht Z. Brunilda Gjineci, e cila ka hartuar një statut për krijimin e një shoqërie private. Konstatohet se është meqenëse me zotësi të plotë juridike për të vepruar për identitetin e të ciles u sigurova me dokumentin personal. Në nënshkrimin përpara meje Neteres, në Neterja e vertetohet atë rregullisht.

NOTERE



Handwritten signature